

EKSPERTE KONTABËL E
RREGJISTRUAR
EFTALI QIRJAQI

Adresa: Rruga "Vilson"
Sheshi 2 Prilli
Shkodër, Albania

Tel: (+355 4) 041746
Cel: 0692079434
E-mail: eliqirjaqi@yahoo.com


RAPORT I EKSPERTIT KONTABËL TE RREGJISTRUAR

PËR AUDITIMIN LIGJOR TË FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA PËR
FUSHATËN ZGJEDHORE 2011

PARTIA E UNITETIT KOMBËTAR

Eftali Qirjaqi

EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR


EFTALI QIRJAQI
ALBANIA

Shkodër më 24 Dhjetor 2011

EKSPERTE KONTABËL E
RREGJISTRUAR
EFTALI QIRJAQI

Adresa: Rruga "Vilson"
Sheshi 2 Prilli
Shkodër, Albania

Tel: (+355 4) 041746
Cel: 0692079434
E-mail: eliqirjaqi@yahoo.com

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE RREGJISTRUAR

Për ekspertimin e fondeve të përfituara dhe shpenzimet e kryera ne fushatën Zgjedhor 2011, nga Subjekti Zgjedhor „Partia e Unitetit Kombëtar“ Tiranë

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve.

Adresa: Pallati i Kongreseve, Tiranë.

Subjektit Zgjedhor: Partia e Unitetit Kombëtar.

Adresa : Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla 1, Tiranë.

Unë kam audituar pasqyrën bashkalidhur, të fondeve te përfituara dhe shpenzimeve të kryera te subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar” për fushatën Zgjedhor 2011.

Përgatitja dhe deklarimi i pasqyrës, është përgjegjësi e drejtimit të subjektit zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar”. Kjo pasqyrë është përgatitur nga vet drejtimi i partisë, bazuar në librin e llogarive dhe të rregjistrimit të posaçëm, miratuar si model me vendim 266 date 01.06.2009, të KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet financiare në lidhje me fushatën Zgjedhor, që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtimit pagesave.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tonë.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) në referencë të vecantë me SNA 800 „Konsiderata të veçanta-Auditimet e Pasqyrave Financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike. Këto standarte kërkojnë, që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri te arsyeshme, se kjo pasqyrë nuk përmban anomali materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi ne lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrën bashkalidhur. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm, që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Politika kontabile e ndjekur nga ana e Partisë së Unitetit Kombëtar, është përgatitja e pasqyrës bashkëlidhur, mbi bazën e fondeve të përfituara dhe

EFTALI QIRJAQI
ALBANIA

EKSPERTE KONTABËL E
RREGJISTRUAR
EFTALI QIRJAQI

Adresa: Rruga "Vilson"
Sheshi 2 Prilli
Shkodër, Albania

Tel: (+355 4) 041746
Cel: 0692079434
E-mail: eliqirjaqi@yahoo.com

shpenzimeve te realizuara gjatë periudhës së fushatës Zgjedhor. Mbi këtë bazë, fondet e pëfituara njihen kur fitohen në lek ose në materiale dhe shërbime të konvertuara me indeksin e vlerësimit nga organizmat përkatëse dhe shpenzimet njihen si të tilla në momentin që ato janë kryer.

Unë çmoj se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë.

Për mendimin tim, mbi bazën e deklarimeve të subjektit zgjedhor dhe evidencës së auditimit të përpunuar, subjekti Zgjedhor rezulton të mos ketë përfitime fondesh publike e jopublike në rruge bankare dhe në CASH nga asnjë person tjetër fizik dhe juridik vendas, fonde e shpenzime që kanë lidhje me fushatën Zgjedhor të zgjedhjeve lokale te vitit 2011. Shpenzimet e realizuara janë përballuar nga fondet personale të drejtuesit të subjektit Zgjedhor, por të justifikuara pjesërisht me dokumenta standarte sipas percaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 90 te ligjit nr.10019 date 29.02.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Deklarimet e subjektit Zgjedhor janë ne përputhje me kërkesat e ligjit nr.10019 datë 29.02.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë" dhe standarteve kohorente të pranuar e që janë në fuqi.

Pa modifikuar opinionin tim, tërheq vëmëndjen se subjekti duhet të tregojë kujdes në mbështetjen me dokument justifikues tatimor të shpenzimeve, duke zbatuar kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë neni 90 paragrafi 3, ku thuhet se cdo shpenzim i kryer për fushatën Zgjedhor dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Eksperti Kontabël i Rregjistruar
Eftali Qirjaqi
Nr Licensë 11 date 20/02/2000

Shkodër më 24 Dhjetor 2011

EFTALI QIRJAQI
ALBANIA